

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR REGJISTRIMIN, MËNYRËN E PËRDORIMIT DHE KONTROLLIN E MJETEVE LUNDRUESE TURISTIKE DHE TË KËNAQËSISË ME MOTORR ME FUQI MBI 30 KW OSE 40.8 KF, ME TONAZH NËN 150 GT”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë me motorr me fuqi mbi 30 KW ose 40.8 KF, me tonazh nën 150 GT”, i propozuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Brendshme, ka për qëllim rregullimin e mënyrës së regjistrimit, përdorimit dhe kontrollit të mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë me motor mbi 30 kw ose 40.8 kf, me tonazh nën 150 GT.

Objektivat që synohen të arrihen përmes miratimit të këtij projektligji dhe zbatimit të tij janë: (i) rregullimi i mënyrës së regjistrimit të mjeteve lundruese duke krijuar një regjistër elektronik i cili të jetë i aksesueshëm edhe nga institucionet e tjera ligj zbatuese; (ii) përcaktimin e normave të lundrimit në det dhe ujërat e brendshme tokësore; (iii) monitorimin sa më mirë të mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë që operojnë në det dhe ujërat e brendshme tokësore.

Projektligji “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë me motor me fuqi mbi 30 KW ose 40.8 KF, me tonazh nën 150 GT” në vetvete i referohet dhe ndryshon ligjin nr. 8663, datë 18.09.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT” i ndryshuar i cili në kohën e miratimit ka pasur qëllim disiplinimin e përdorimit dhe sigurimin e kontrollit të mjeteve të vogla lundruese duke krijuar disa dispozita të tepërta monitoruese të cilat ndikojnë në frenimin e turistëve që vijnë me mjete lundruese turistike apo të kënaqësisë dhe që kërkojnë të vizitojnë bregdetin shqiptar.

Gjithashtu, për hartimin e këtij projektligji janë shqyrtuar dhe marrë në konsideratë konventat detare ndërkombëtare, të tilla si: Konventa Për shpëtimin

e jetës në det (SOLAS), konventa për mbrojtjen e detit nga ndotja nga anijet (MARPOL), konventa për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore, Konventa për mbrojtjen e jetës detare dhe zonës bregdetare mesdhetare, Konventa Ndërkombëtare e Kërkimit Detar dhe Shpëtimit, Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes së Shkaktuar nga Anijet, si dhe të gjitha parimet dhe standardet e akteve të Bashkimit Evropian mbi lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projektakti është në përputhje me Programin politik të Këshillit të Ministrave, pasi ndikon drejtpërdrejt në rritjen e turizmit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Industria e turizmit ka kontribut të madh në ekonomi në terma monetarë dhe në ato të punësimit. Në programin e saj qeveria synon të nxisë diversifikimin e turizmit në mënyrë që të kemi një turizëm më të qëndrueshëm dhe përgjatë gjithë vitit, përmes arritjes së objektivave si: centralizmi i procesit të planifikimit në turizëm, reformimit të institucioneve/agjencive që merren me turizmin, vendosjen e rregullt në treg të të gjithë operatorëve ekonomikë në fushën e turizmit (agjenci, operatorë turistikë, udhërrëfyes dhe struktura mikpritëse), si dhe përmirësimin e legjislacionit.

Industria e turizmit në Shqipëri varet në një pjesë të madhe nga deti dhe llojet e turizmit të lidhura me të, por edhe në ujërat e brendshme tokësore si liqene dhe lumenj të lundrueshëm.

Në kuadër të përmbushjes së prioriteteve të qeverisë shqiptare lidhur me regjistrimin dhe monitorimin e mjeteve lundruese, nxitjen e turizmit “si burim i rëndësishëm ekonomie e zhvillimi”, mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Transportit 2016-2020 ku në Veprimin Prioritar 11 është parashikuar “Zhvillimi i skemave të stimujve për tërheqjen dhe promovimin e turizmit detar dhe lundrimeve argëtuese turistike në Shqipëri” edhe në Strategjinë Kombëtare të Turizmit, e cilëson të nevojshëm miratimin e projektligjit të propozuar edhe si një përgjigje e përshtashme dhe e domosdoshme ndaj kërkesës në rritje për hyrjen dhe qarkullimin në ujërat territoriale shqiptare të mjeteve lundruese turistike.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji nuk është parashikuar në Planin e Përgjithshëm Analitik të hartimit të akteve ligjore/nënligjore për vitin 2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë me motor me fuqi mbi 30 KW ose 40.8 KF, me tonazh nën 150 GT”, është hartuar si rezultat i nevojës për të lehtësuar procedurën regjistrimin të mjeteve lundruese dhe monitorimit të lundrimit të metëve turistike dhe të kënaqësisë në ujërat detare dhe ujërat e brendshme tokësore të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të nismës që ka Qeveria Shqiptare për kthimin e Shqipërisë në një atraksion turistik, me potencial përfitues për sipërmarrjet në fushën e turizmit.

Bregdeti shqiptar ka potenciale të pashfrytëzuara, me një numër të konsiderueshëm gjiresh të virgjëra që shtrihen përgjatë vijës bregdetare për krijimin e porteve turistike/marinave. Oferta për këtë lloj turizmi duhet të drejtohet drejt turistëve që vizitojnë vendin tonë me jahte dhe mjete lundruese të cilat ofrojnë siguri të lartë.

Aktualisht monitorimi i mjeteve lundruese rregullohet nga ligji nr. 8663, datë 18.09.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT” i ndryshuar, i cili ka qenë nga të parat ligje të miratuara për regjistrimin dhe monitorimin e lundrimit të mjeteve turistike në ujërat detare të RSH-së. Ky ligj i jep attribute monitoruese shumë të detajuara të cilat ndikojnë në bezdisjen e turistëve që vijnë me mjete lundruese turistike dhe frenimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit që vijnë nga turizmi.

Për këtë arsye u shfaq si domosdoshmëri ndryshimi i ligjit nr. 8663, datë 18.09.2000 dhe rregullimi i dispozitave me qëllim forcimin e monitorimit të mjeteve lundruese dhe krijimin e kushteve të nevojshme për shtimin e të ardhurave nga Turizmi.

Për këtë arsye, projektligji i propozuar synon harmonizimin dhe unifikimin e dispozitave lidhur me regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë në Republikën e Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është në përputhje me nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e transportit detar të ratifikuara nga RSH dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon fushën e transportit detar dhe atë turistik, siç është ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, i cili në nenin 32 “Drejtimi Qendror shtetëror” ka parashikuar brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për transportin detar e cila administron dhe menaxhon transportin detar të mallrave dhe njerëzve, portet detare të hapura për qëllime ekonomike, Regjistrin e Mjeteve Lundruese dhe klasifikimin e tyre, plotësimin e kushteve për sigurinë e jetës së njerëzve dhe mjeteve lundruese, etj. Ndërsa në nenin 399 “Aktet ligjore për lundrimin turistik” parashikohet që “Veprimtaria për lundrimin turistik rregullohet me akte nënligjore të përbashkëta ndërmjet ministrive që mbulojnë fushat përkatëse”.

Projekt-Ligji është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ratifikuar me Ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”. Neni 59, Pika 2(dy) i Kapitullit III “Ofrimi i Shërbimeve” përcakton se palët angazhohen të respektojnë detyrimet ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e standardeve të sigurisë, sigurimit dhe të mjedisit.

Miratimi i projektligjit është në përputhje me Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020 miratuar me Vendim të KM nr. 811, datë 16.11.2016 në të cilën në Projektin Strategjik 1 Objektivi 1.1 është përcaktuar “Përmirësimi i sistemit rregullator detar në pajtim me standardet dhe rregulloret e IMO dhe BE-së” dhe Veprimi Prioritar Detar 1 “Ratifikimi dhe nënshkrimi i rregulloreve të IMO-së dhe BE-së mbi sigurinë detare, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin bregdetar” si edhe Veprimi prioritar DETAR 11 Zhvillimi i skemave të stimujve për tërheqjen dhe promovimin e turizmit detar dhe lundrimeve argëtuese turistike në Shqipëri.

Miratimi i projektligjit bëhet në zbatim të detyrimeve që ka RSH si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Duke pasur parasysh këtë, projektligji është një hap i ri në zhvillimin e sektorit turistik-rekreativ duke pasur si pikë reference, përveç konventave detare ndërkombëtare, edhe i të gjitha parimet e akteve të Bashkimit Evropian mbi lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji është konceptuar në 9 Pjesë, duke parashikuar rregullime specifike për secilën pjesë dhe konkretisht:

Pjesa I e projektligjit përcakton qëllimin, i cili rregullon mënyrën e regjistrimit, të përdorimit dhe të kontrollit të mjeteve lundruese turistike dhe të kënaqësisë me motor mbi 30 KW ose 40.8 KF, me tonazh nën 150 GT. Kjo pjesë përcakton gjithashtu fushën e zbatimit të projektligjit dhe përkufizimet e termave të përdorur në të.

Pjesa II e projektligjit parashikon respektimin e normave të lundrimit në det dhe në ujërat e brendshme tokësore, detyrimet e përgjithshme që duhet të zbatojnë mjetet lundruese dhe përdoruesit e tyre. Detyrimin për njoftimin në nisje dhe mbërritje dhe elementët e këtij njoftimi si edhe krijimin, mirëmbajtjen e regjistrimit elektronik të mjeteve lundruese dhe institucionet shtetërore që do të kenë të drejta aksesi.

Pjesa III e këtij projektligji përcakton përgjegjësitë e subjekteve detare për deklarimin me shkrim, pranë pikave të kalimit kufitar, duke shënuar vendqëndrimin, vend bazimin e mjetit dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve si dhe regjistrimin e mjetit lundrues. Gjithashtu në këtë pjesë përcaktohen kushtet dhe veprimet që do të kryhen nga pronarët e mjeteve lundruese për ndryshimin e pronësisë.

Kreu IV e projektligjit parashikon përgjegjësitë e fabrikave dhe kantierëve detare për të regjistruar të gjitha mjetet lundruese që prodhojnë apo riparojnë në një regjistër i cili të jetë i protokolluar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Në Pjesën V parashikohen detyrimet e pronarëve të mjeteve lundruese që nuk janë regjistruar në Republikën e Shqipërisë për deklarimin në sistemin e posaçëm të komunikimit në çastin e mbërritjes në port, kohën e parashikuar të

qëndrimit në ujërat territoriale shqiptare si dhe afatin maksimal të qëndrimit në territorin e RSH.

Pjesa VI përcakton ndalimet që duhet të kenë parasysh pronarët apo përdoruesit e mjeteve lundruese gjatë kryerjes së aktivitetit të lundrimit turistik në ujërat detare apo ato të brendshme.

Pjesa VII përcakton sanksionet për mos regjistrimin e pronësisë së mjetit brenda afatit, mos pasjen apo refuzimin e paraqitjes së dokumenteve gjatë lundrimit, mungesa e regjistrimit, ndryshimi apo falsifikimi i karakteristikave të mjeteve lundruese, tejkalimi i numrit të personave që transportohen, Përdorimi i mjetit lundrues për veprimtari të kundërligjshme, etj.

Pjesa VIII parashikon që sanksionet e këtij ligji zbatohen edhe kur bëhet fjalë për pjesë të mjeteve lundruese të cilat, në bazë të të dhënave të bazuara, të vendndodhjes, të mënyrës së fshehjes në ngarkim të pronarit ose të bashkëpronarëve, të mbajtësit ose të zotëruesit, që janë të destinuara për formimin, ndryshimin ose montimin e mjeteve lundruese.

Pjesa IX parashikon procedurat e ankimit administrativ, aktet nënligjore që do të hartohen në zbatim të këtij ligji, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, ministria përgjegjëse për turizmin, ministria përgjegjëse për rojën bregdetare si dhe çdo institucion tjetër brenda fushës së përgjegjësisë së tij.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Projektligji u hartua nga një grup pune i përbërë nga përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Prefekti Durrës, Drejtoria e Përgjithshme Detare.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë si detyrim ngritjen e dy sistemeve elektronike:

Sistemi i parë do të quhet Regjistri Elektronik i Mjeteve Lundruese i cili do të ketë si funksion krijimin e një regjistri elektronik ku do të regjistrohen të gjitha mjetet lundruese dhe në të cilin do të kenë akses institucionet ligjzbatuese si Gjykata, Prokuroria, Policia etj. Ky sistem do të lehtësojë punën për regjistrimin e mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë si edhe forcojë bashkëpunimin dhe koordinimin e punës midis institucioneve për monitorimin e tyre.

Sistemi i dytë quhet “Sistemi i posaçëm elektronik për lëvizjen e mjeteve Lundruese”. Ky sistem do të vendoset në Kapiteneritë e porteve të cilat në zbatim të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë do të monitorojnë lundrimin e të gjitha mjeteve lundruese në hapësirën detare dhe ujerat e brendshëm tokësor të Republikës së Shqipërisë. Ky sistem do të lehtësojë procedurat e lejeve dhe raportimeve të mjeteve lundruese që kanë dëshirë të lundrojnë përgjatë bregdetit shqiptar. Me ligjin nr. 8663, datë 18.09.2000 pronarët e mjeteve lundruese duhet të marrin leje lundrimi me shkrim nga policia kufitare ndërsa me sistemin aktual mjafton raportimi elektronik në këtë sistem dhe leja do të jepet në rrugë elektronike.

Sipas një vlerësimi paraprak është parashikuar që kostoja ekonomike për ngritjen e këtyre dy sistemeve shumë të rëndësishme për transportin detar do të jetë afërsisht 35 milion lekë të cilat do të mbulohen nga buxheti i shtetit.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Belinda BALLUKU

Konceptoi punoi:	Elson Thana,	Datë: 01/07/2020
Miratoi:	Albiona Korita	
Miratoi:	Bledar Karoli	
Miratoi:	Enea Karakaçi	
Miratoi:	Kledia Ngjela	
Miratoi:	Eltar Deda	
Miratoi:	Viola Haxhiademi	